



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ae.nr.104/2018

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, Liridon Maloku dhe Qerim Ademaj, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit [“G...”] sh.p.k me seli në Istog, e përfaqësuar sipas autorizimit nga avokati [F.GJ] nga Pëja, kundër të paditurës “Ministria e Infrastrukturës” me seli në Prishtinë, e përfaqësuar sipas autorizimit nga avokati Shefqet Hasimi, në kontestin për pagesën e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të paditësit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, C.nr.640/2014, i datës 19.03.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt.19.05.2020, mori këtë:

A K T V E N D I M

PRISHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, C.nr.640/2014, i datës 19.03.2018, dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Ekonomike, e ka refuzuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadia e paditësit [“G...”] sh.p.k me seli në Istog lidhur me pretendimin e palës paditëse për pagesën e borxhit kryesore në shumën e përgjithshme prej 30,404.40€, me kamate ligjore prej 8% duke filluar nga data e faturuar në emër të furnizimit me kripë për mirëmbajtjen e rrugëve e deri në pagesën definitive të borxhit. Ndërsa në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit ka vendosur që shpenzimet e procedurës kontestimore ti bartin secila pale veç e veç.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë përfaqësuesi i paditësit për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Apelit ta ndryshojë aktgjykimin e ankimuar, ashtu që ta aprovoje kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të bazuar dhe të paditurin ta obligojë në pagesën e shpenzimeve procedurale, ose të njëjtin ta prishe dhe lëndën t’ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Përgjigje në ankesë nuk ka.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi ["G..."] sh.pk me seli në Istog, me datën 17.12.2014 ka paraqitur padi pranë gjykatës së shkallës së parë, kundër të paditurit "Ministria e Infrastrukturës" me seli në Prishtinë lidhur me pagesën e borxhit në shumën e përgjithshme 30,404.40€, duke kërkuar ne të njëjtën kohë nga gjykata aprovimin e saj si të bazuar pas administrimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave ka konstatuar së me rastin e refuzimit në tërësi të kërkesëpadisë së paditësit për pagesën e borxhit kryesore në shumën e përgjithshme prej 30,404.40€ në emër të furnizimit me kripë për mirëmbajtjen e rrugëve, është bazuar në dispozitat e nenit 52 të LMD-së, si dhe nenin 26 paragrafi 2 të Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës me nr.04/L042.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK-së, e vlerëson aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë brenda kufijve të shkaqeve ankimore të theksuara në ankesë, duke i vështruar sipas detyrës zyrtare shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 nën pikën b), g), j), k) dhe m) të këtij ligji dhe aplikimin e drejtë të së drejtës materiale.

Gjykata e shkallës së dytë ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.1 dhe 182 par. 2 pika n), për arsye se aktgjykimi ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me vetveten dhe me arsyet e aktgjykimit, nuk janë treguar arsyet për faktet vendimtare respektivisht arsyet e dhëna janë të paqarta, ekzistojnë kundërthënie për faktet vendimtare midis asaj që jepet në arsyet e aktgjykimit dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e atakuar e ka marrë me shkelje të nenit 8 të LPK-së, për arsye se nuk i ka vlerësuar me kujdes të veçantë secilën provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, por në mënyrë të njëanshme duke ia falur besimin me tepër pretendimeve të palëve ka marrë vendimin e atakuar. Sipas Nenit 8.2 të LPK-së, gjykata ka për obligim që me ndërgjegje dhe me kujdes ta çmojë çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku për të ardhur te e vërteta materiale. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka marrë vendimin e atakuar, pa qartësuar plotësisht gjendjen faktike sepse nuk e ka theksuar se cilat fakte i ka vërtetuar me provat e administruara, por është mjaftuar vetëm më theksimin e provave të administruara.

Gjykata e shkallës së dytë nuk mund ta pranojë këtë qëndrim të gjykatës së shkallës së parë nga shkak se, provimi i fakteve varësisht prej llojit dhe natyrës së faktit është detyrë e palëve si dhe e gjykatës. Gjatë procedurës gjyqësore objekt i të provuarit duhet të jenë të gjitha faktet relevante të cilat janë me ndikim në vendosjen e çështjes. Gjykata ka për detyrë që gjendja

faktike të vërtetohet në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe në këtë drejtim duhet të kujdeset që të administrohen të gjitha faktet të cilat janë thelbësore për epilogun e kontestit.

Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë pa e vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë, respektivisht pa vlerësuar vlefshmërinë e provave kontestuese dhe pa qartësuar bazën juridike të krijimit të detyrimit, ka refuzuar kërkesëpaditë e paditësit

Mos vërtetimi i vlefshmërisë së provave kontestuese, si prova të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në nxjerrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë, përbejnë shkelje të dispozitës së Nenit 183.1 të LPK-së, i cili përcakton *“se ekziston vërtetimi i gabuar apo jo i plotë i gjendjes faktike kur gjykata gabimisht e ka vërtetuar ndonjë fakt vendimtar, përkatësisht kur faktin e tillë nuk e ka vërtetuar fare”*.

Poashtu aktgjykimi i atakuar është marrë edhe me shkelje të dispozitës së nenin 160.5 e cila përcakton se: "gjykata posaçërisht tregon se cilat dispozita të së drejtës materiale i ka zbatuar me rastin e vendosjes mbi kërkesat e palëve, ndërsa aktgjykimi i atakuar perkundër faktit të referimit në dispozitat e Neneve 52 të LMD-së dhe Nenit 26 par. 2 të LPPK, nuk jep fare arsytim se pse në rastin konkret zbatohen dispozitat e cekura, prandaj Gjykata e Apelit nuk mund ta vlerësojë ligjshmërinë e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.

Shkeljet e tilla përfaqësojnë shkelje thelbësore të dispozitave të LPK-së nga Neni 183.1 dhe Neni 160 par. 3, 4 dhe 5 të LPK-së, që kanë pasur ndikim në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë andaj aktgjykimi i atakuar doemos është dashur të priset.

Në ri-procedurë gjykata e shkallës së parë duhet evituar shkeljet e theksuara më lartë, duke evituar kundërthëniet ekzistuese në mes dispozitivit me arsyetimin, arsyetimit me faktet vendimtare dhe sipas nevojës të nxjerrë provat e nevojshme për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe pas kësaj të marrë vendim të ligjshëm dhe të drejtë duke dhënë arsytim të duhur konform dispozitave të sipercekura.

Nga të cekurat u vendos sikurse në vendim në bazë të nenit 195.1 nën pikën c) të LPK.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Ae.nr. 104/2018 data 19.05.2020

KRYETARI I KOLEGJIT,
Mahir Tutuli, d.v

